

The background features a series of thin, flowing lines in shades of blue and purple that create a sense of movement and depth, resembling a stylized wave or a dynamic pattern.

RAPORT TRANSPARENCE Viti 2024



Përmbajtja

Mesazhi i drejtimit- Studio" VIAR- Consulting" sh.p.k.	2
1. Rreth VIAR-Consulting	3
1.1. Misioni Ynë	3
1.2. Vlerat Tona	3
2. Fokus i ri për Transparencën tonë	4
3. Fokus mbi Angazhimet dhe marrëdhëniet me klientet.....	5
3.1. Pranimi i klienteve dhe vazhdimësia	5
3.2. Vlerësimi i riskut të klientit.....	5
3.3. Vlerat dhe kultura e biznesit.....	5
3.4. Sigurimi i cilësisë	6
3.5. Deklaratat e pavarësisë	6
3.6. Kontrollat e konfliktit të interesit dhe pavarësisë	6
3.7. Monitorimit të praktikave pavarësisë	7
4. Përse duhet të zgjidhni Studio "VIAR-CONSULTING"	7
5. Shërbimet e Studio" VIAR-Consulting" sh.p.k.....	8
5.1. Shërbime Financiare dhe Kontabiliteti	8
5.2. Shërbime të Auditimit dhe Sigurisë.....	8
5.3. Konsulencë Ekonomike, Financiare dhe Fiskale	9
5.4. Vlerësime të Aktiviteteve Tregtare.....	10
5.5. Vlerësime të Pasurive të Luajtshme & Paluajtshme.....	10
5.6. Përgatitje Plan Biznes	10
5.7. Shërbime Këshillimi të Specializuara	10
6. Industritë	11
7. Staf i Profesional.....	11



Mesazhi i drejtimit- Studio" VIAR- Consulting" sh.p.k.

Në Studio" VIAR- Consulting" sh.p.k., ne jemi të angazhuar në kryerjen e vazhdueshme të auditimeve të cilësisë së lartë, përsosmërisë profesionale dhe shërbimit ndaj klientëve tanë, investitorëve dhe tregjeve të kapitalit. Ne kuptojmë se mjedisi ynë është duke ndryshuar vazhdimisht, duke rezultuar në rritjen e kompleksitetit, ndryshimeve teknologjike dhe pritshmërive më të larta të komunitetit dhe rregullatorëve. Ne i përgjigjemi këtyre ndryshimeve, duke ngritur standardet e cilësisë së auditimit nëpërmjet inovacionit dhe transformimit. Transformimi është një program i koordinuar në të gjithë rrjetin tonë global që do të na mundësojë të zgjerojmë aftësitë dhe vlerat që u ofrojmë klientëve. Një mundësi për të ofruar shërbime të vazhdueshme auditimit dhe dhënies së sigurtisë me një cilësi të lartë, çdo herë, kudo. Në mënyrë që të nxisim përmirësime të vazhdueshme në cilësi, ne po transformojmë auditimin nëpërmjet përdorimit të mjeteve dhe teknologjive më innovative, siç janë teknikat e përparuara analitike, përfshirë zgjidhjet analitike Alchemy të zhvilluara lokalisht nga ne. Në të njëjtën kohë, po përmirësojmë programet tona të të mësuarit dhe zhvillimit për të siguruar aftësitë e kërkuara nga audituesi i gjeneratës së ardhshme, në një të ardhme të prirur drejt dixhitalizimit.

Investimi ynë në cilësinë e auditimit është fokusuar gjithashtu në sistemet dhe proceset tona për të monitoruar dhe matur performancën e auditimeve tona. Programi ynë për Monitorimin dhe Matjen e Cilësisë së Auditimit fokusohet në sigurimin e ekzekutimit të vazhdueshëm të auditimeve të cilësisë së lartë. Një element kyç i programit është përdorimi i teknologjisë për të rritur aftësinë e identifikimit të problematikave të cilësisë së auditimit gjatë kryerjes së auditimit më tepër sesa përmes rishikimeve të cilësisë pas auditimit.





1. Rreth VIAR-Consulting

Studio "VIAR-Consulting" sh.p.k. është një studio auditimi dhe konsulence ekonomike-financiare, e themeluar më 15/10/2007, e cila ofron shërbime në fushën financiare të tilla si:

- Auditimi Ligjor dhe të gjitha llojet e shërbimeve sipas SNA-ve
- shërbime kontabiliteti,
- Konsulencë tatimore; Shërbime tatimore,
- Hartimi i Pasqyrave Financiare; Rishikimi të pasqyrave financiare,
- Hartime Plan biznesesh,
- Rivlerësim asetesh,
- Vlerësim biznesesh
- Auditimi i brendshëm dhe i jashtëm i korporatave.

Studio e ushtron aktivitetin e saj në Tiranë, pranë rrugës "Luigj Gurakuqi", Lagjia Nr.2, ku ndodhen dhe ambientet e biznesit.

1.1. Misioni Ynë

Misioni i studio "VIAR" Consulting është pozicionimi në tregun Shqiptar si model për cilësinë e shërbimeve të ofruara, integritetin profesional dhe etikën.

1.2. Vlerat Tona

- Eksperienca, profesionalizmi, integriteti, etika dhe përkushtimi i stafit janë vlerat kryesore të studio "VIAR-Consulting".
- Duke kuptuar fillimisht nevojat dhe pritshmëritë e partnerit Ne investojmë të gjithë kapacitetin tonë për përmbushjen e tyre.
- Asgjë nuk është më prioritare për aktivitetin tonë sesa kënaqësia dhe dobia që merr partneri nga shërbimet tona.





2. Fokus i ri për Transparencën tonë

Në "VIAR-Consulting" besojmë se cilësia e auditimit është gurthemeli i besimit në raportimin financiar dhe tregjet financiare. Studio "VIAR-Consulting" vazhdimisht përmirëson qasjen për t'iu shërbyer klientëve duke iu kushtuar rëndësi faktorëve të jashtëm dhe faktoreve të brendshëm. Është qëllimi dhe angazhimi ynë për të siguruar dhe për të iu ofruar klientëve tonë auditime me cilësi të lartë dhe me vlerë.

Cilësia e auditimit ka qenë gjithmonë një përparësi kryesore brenda Studio "VIAR-Consulting". Duke qenë se kemi investuar dhe përqendruar përpjekjet tona në këtë fushë për shumë vite, ne tani kemi krijuar një themel shumë të fortë në këtë fushë. Kjo gje na siguron në mundësinë që të permbushim sipas standarteve dhe rregullave kërkesat në rritje të klientëve, shpejt dhe pa probleme.

I gjithë personeli që kryen angazhimin ka kualifikimin e duhur për të ndjekur procedurat dhe politikat të percaktuara nga Standartet Nderkombetare të Kontrollit të Cilësisë, duke permbushur të gjitha Kërkesat Perkatëse Etike.

Bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 10091 dt. 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", paraqesim të detajuar lloji e të ardhurave.

Të ardhurat e studios sonë për vitin 2024 janë:

Ne 000/lek

Lloji shërbimit

Studio" VIAR-Consulting" sh.p. k 2024

Auditim Ligjor të njësive ekonomike me interes publik (NIP)	4,357
Auditim Ligjor të njësive ekonomike me jo interes publik (Jo-NIP)	1,682
Sherbime të tjera të dhenies së sigurisë, kontabiliteti, konsulence dhe të tjera.	3,799
Total	9,838

Tabela 1: Te ardhurat për vitin 2024, sipas shërbimeve

Në menyrë të detajuar paraqesim listën e entiteteve me interes publik të audituara nga studio jonë gjatë vitit 2024, sipas Tabelës. 2 më poshtë:

Nr.	Entiteti	Nr.	Entiteti
1	Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a	6	Green Belsh sha
2	Korporata Elektroenergjitke Shqiptare (KESH) sh.a	7	Top Albania sha
3	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)	8	Gen-I Tirana sh.p.k
4	Bursa Shqiptare e Energjise Elektrike/ALPEX sh.a	9	HEC Lashkiza shpk
5	Tregu I Shitjes Shumice Fruta-Perime" sh.a	10	Perparimi SK shpk

Tabela 2: Lista e entiteteve NIP të audituara për vitin 2024



Ne pretendojmë se realizojmë auditime ligjore cilësore, vetëm nëse ne kemi besimin si të atyre që mbikëqyrin punën tonë, ashtu edhe të atyre të cilët mbështeten në punën tonë. Për ta krijuar këtë besim, jemi treguar të kujdesshëm në angazhimin dhe veprimet tona, për të arritur cilësi sa më të lartë të shërbimeve audituese dhe të shërbimeve të tjera jo audituese. Ne ju ftojmë të rishikoni Raportin tonë të Transparencës për vitin 2024 i cili tregon historinë tonë të auditimit dhe angazhimit për cilësi dhe transparencë.

3. Fokus mbi Angazhimet dhe marrëdhëniet me klientet

3.1. Pranimi i klienteve dhe vazhdimësia

Para se të hyjmë në një marrëdhënie me çdo klient të ardhshëm, dhe gjatë gjithë marrëdhënies sonë me cilindo klient, ne konsiderojmë dhe dokumentojmë, midis gjerave të tjera:

- Kompetencën dhe aftësinë e ekipeve të angazhimit duke përfshirë njohuritë dhe kualifikimet që kanë për këtë subjekt;
- Pavarësinë e firmës, partnerëve dhe stafit, si dhe ekipit të angazhimit
- Profilin e riskut të klientit;
- Nëse tarifat janë të përshtatshme për angazhimin dhe nuk krijojnë varësi të panevojshme nga një klient.

3.2. Vlerësimi i riskut të klientit

Për të përmbushur kërkesat ligjore dhe rregullatore, të kuptuarit e klientëve tanë dhe risqet është thelbësore për aftësinë tonë për të ofruar edhe "Shërbim klientëve të jashtëzakonshëm /Exceptional Client Service".

Ne kemi një politikë të vlerësimit të riskut të klientit, e cila përcakton kërkesat dhe procedurat për të përcaktuar një vlerësim të rrezikut të klientit për të gjitha angazhimet e auditimit.

3.3. Vlerat dhe kultura e biznesit

Janë përcaktuar planet strategjike të cilat përfshijnë detaje për llojet e klientëve që studio jonë do të synojë në treg, duke vlerësuar vlerat dhe kulturën që ka në biznesin e klientit të synuar. Studio jonë ofron trajnim për stafin gjatë gjithë karrierës së tyre mbi rreziqet ndaj pavarësisë dhe llojeve, natyrave të klientëve me të cilët "VIAR-Consulting" shpk synon të punojë.

Studio "VIAR", partnerët, stafi [ekipi angazhimi janë të pavarur]

Pavarësia e Studios, partnerëve dhe stafit dhe ekipi i angazhimit administrohet përmes politikave, procedurave dhe sistemeve kombëtare të pavarësisë së firmës, të dizajnuara për të adresuar parimet dhe kërkesat sipas SNA-ve. Politikat dhe procedurat përfshijnë, ndër të tjera, marrëdhëniet tona me klientët e auditimit ligjor, mbikëqyrjen e gjatë të personelit me



klientët e sigurtë, tarifat dhe ofrimin e shërbimeve jo-audituese për klientët tonë.

3.4. Sigurimi i cilësisë

Anëtarët e ekipit të Studio "VIAR-Consulting" pritët të kryejnë të gjitha angazhimet në standardet më të larta profesionale, duke ruajtur integritetin.

Atyre u kërkohet të respektojnë të gjitha standardet kombëtare të zbatueshme për të gjitha aspektet e punës së tyre. Këto përfshijnë auditimin, pavarësinë dhe çdo standard tjetër të lëshuar, i cili ndikon në punën e tyre. Ata gjithashtu pritët të respektojnë Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionale të lëshuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) përmes Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA) dhe të kryejnë auditime në standarde jo më të ulëta se ato që përmbahen në Standardet Ndërkombëtare mbi Auditimin (ISA) lëshuar nga IFAC përmes Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Auditimit dhe Sigurimit (IAASB).

Anëtarët gjithashtu kërkohet të respektojnë Standardin Ndërkombëtar të Kontrollit të Cilësisë (ISQC) të IFAC.

Studio "VIAR" ka krijuar një sistem të brendshëm të kontrollit të cilësisë, i dizajnuar për të siguruar një siguri të arsyeshme që anëtari dhe personeli i tij të jenë në përputhje me standardet profesionale dhe rregullatore dhe kërkesat ligjore, dhe që raportet e lëshuara nga anëtari ose partneri i angazhimit janë të përshtatshme në rrethana.

3.5. Deklaratat e pavarësisë

Procesi i deklarimit të pavarësisë kërkon konfirmim nga partnerët dhe stafi për fillimin e punësimit me Studion "VIAR-Consulting" dhe çdo vit pas kësaj që politikat tona rreth marrëdhënieve financiare, biznesi, punësimi dhe marrëdhëniet personale janë respektuar dhe kërkon që të gjitha marrëdhëniet e tilla të deklarohen.

Deklarata vjetore të pavarësisë është kryer në çdo fillim viti.

Të gjithë anëtarët e ekipit të angazhimit të auditimit ligjorë, përfshirë ekspertët e brendshëm, janë të detyruar të konfirmojnë dhe shpallin pavarësinë e tyre në lidhje me angazhimin para fillimit të auditimit ligjorë. Kjo deklaratë është e dokumentuar dhe e ruajtur në dosjen e angazhimit të auditimit të auditimit.

3.6. Kontrollët e konfliktit të interesit dhe pavarësisë

Sistemi i menaxhimit të pavarësisë ndihmon studion në demonstrimin e pajtueshmërisë me kërkesat profesionale, rregullatore dhe ligjore duke mbajtur dëshmi të dokumentuara të konflikteve dhe zgjidhjeve të duhura të konfliktit të interesave.

Një kontroll i konfliktit dhe pavarësisë dërgohet rishikohet, për të gjithë partnerët dhe stafin përpara se të pranohet ndonjë angazhim i ri. Një kontroll rishikohet çdo vit për të gjithë klientët e listuar të auditimit të njësisë, si pjesë e procedurave të vazhdimin të klientit.

Kur identifikohet një konflikt, administratorët e riskut të firmës dhe menaxherët e riskut të firmës ndihmojnë në zgjidhjen e konfliktit, duke marrë këshilla nga partneri i riskut të firmës



ose funksioni Kombëtar i riskut dhe etikës, nëse kërkohet. Kur ne nuk jemi në gjendje të zgjidhim siç duhet një konflikt përmes masave të duhura mbrojtëse, atëherë ne nuk pranojmë të veprojmë.

Studio nuk ofron konsulence për klientët që auditon.

Ne kemi politika dhe procedura të vendosura për të identifikuar dhe zgjidhur çdo kërcënim ndaj pavarësisë të krijuar duke ofruar shërbime mos-dhenie sigurie për klientët e auditimit. Partneri i angazhimit të auditimit aprovon çdo shërbim mos-dhenie sigurie të propozuar një klienti të auditimit para se të kryhen shërbimet e mos-dhenies se sigurie. Partneri i angazhimit të auditimit merr në konsideratë çdo konflikt interesi ose kërcënime ndaj pavarësisë që mund të lindë përpara aprovimit të shërbimit të mos-dhenies se sigurie. Sigurimi dhe aprovimi i shërbimeve jo-audituese gjithashtu është rishikuar në mënyrë specifike në një nivel angazhimi, si pjesë e Programit vjetor të kontrollit të brendshëm të firmës.

3.7. Monitorimit të praktikave pavarësisë

Ne monitorojmë praktikën e pavarësisë përmes një serie aktivitetesh monitoruese dhe rishikimi, duke përfshirë:

- Deklaratën vjetore të pavarësisë të ndërmarrë nga të gjithë partnerët dhe stafi, ku përjashtimet shqyrtohen, hetohen dhe zgjidhen.
- Auditimin Vjetor përkatës

4. Përse duhet të zgjidhni Studio "VIAR-CONSULTING" shpk



- Asgjë nuk është më prioritarë për aktivitetin tonë sesa kënaqësia dhe dobia që merr klienti nga shërbimet tona.



- Raporti çmim/cilësi është tepër i favorshëm për partnerët tanë.
- Ne ofrojmë një shërbim të personalizuar duke përmbushur kërkesat specifike të partnerit.
- Ne e përditësojmë praktikën tonë sipas Standarteve të Raportimit Financiar që aplikohen në Shqipëri.

5. Shërbimet e Studio "VIAR-Consulting" sh.p.k.

5.1. Shërbime Financiare dhe Kontabiliteti

Transferimi i funksioneve të kontabilitetit mund të jetë me kosto efektive dhe efikase. Ne mund t'ju ndihmojmë me mbylljen mujore, tremujore dhe vjetore, duke marrë parasysh ndryshimet e kontabilitetit, legjislacionit dhe standarteve. Ju mund të mbështeteni tek ne për të mbështetur tranzicionin e biznesit tuaj në një sistem të ri të kontabilitetit.



5.2. Shërbime të Auditimit dhe Sigurisë

- Auditim i pasqyrave financiare në perputhje me Standartet Ndërkombetare të Auditimit të përgatitura sipas Standarteve Kombetare të Kontabilitetit apo Standartet Ndërkombetare të raportimit Financiar;
- Auditim i raportimeve për qëllime të grupit;
- Rishikim i kontrolleve të brëndshme;
- Auditim në perputhje me rregullat dhe kërkesat e industrive specifike;
- Shërbime të sigurisë në varesi të procedurave të rena dakord me klientin;

“Audituesit luajnë një rol të rëndësishëm në verifikimin e informacionit financiar. Besimi i klienteve në cilësinë e punës së auditimit është parësor. Përmes raporteve të transparencës audituesit mund të tregojnë tregut cilësinë dhe besueshmërinë e auditimeve të tyre”.



Ne auditojmë pasqyrat financiare, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën fitim ose humbje dhe të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve të kapitalit dhe pasqyrën e flukseve të parasë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare të konsoliduara, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.



Studio "VIAR-Consulting" ka krijuar një sistem kontrolli cilesie dhe monitorimi i cili përbëhet nga politika dhe procedura për të kuptuar më mirë atë çfarë duhet të realizohet dhe për të përcaktuar nëse për arritjen e objektivave ka nevojë të bëhet më shumë.

I gjithë personeli që kryen angazhimin ka kualifikimin e duhur dhe ndjek keto procedura dhe politika të përcaktuara nga Standartet Nderkombetare të Kontrollit të Cilesise duke përmbyllur të gjitha Kërkesat Perkatëse Etike. Partneri dhe stafi jone janë të vetëdijshëm dhe kuptojnë Seksionet 290 dhe 291 të Kodit IESBA dhe çdo kërkesë shtesë.

5.3. Konsulencë Ekonomike, Financiare dhe Fiskale





- Analize e implikimeve fiskale të trasaksioneve "cross borders" që bizneset shqiptare që operojnë jashtë vendit apo bizneseve të huaja që kryejnë transaksione të tilla në Shqipëri.
- Kufizimet, avantazhet dhe aplikimi i Marreveshjeve për Eliminimin e Dyfishtë;
- Asistence me procedurat e aplikimit të Marreveshjeve për Eliminimin e Dyfishtë;
- Implikimet në lidhje me shkëmbimin e informacionit fiskal të parashikuara në Marreveshjet e sipërpërmendura;
- Keshillim dhe asistence në lidhje me ceshtjet e Njesise së Përhershme;
- Aplikimi i rregullave të OECD në lidhje me transaksionet "cross-borders";
- Analize e taksave për mënyrën se si ato impaktojnë zgjedhjet strategjike dhe operacionale të shoqërive ndërkombëtare;

Sektorët kryesorë të angazhimit të firmës tonë përfshijnë: Prodhimin, Ndërtimin, Utilitetet, ujë, energji, Shitjen me Pakicë Turizmin, Shëndetësinë, Teknologjinë dhe Telekomunikacionin, Agjencitë Qeveritare, Shërbimet profesionale, Transportin, Shpërndarjen, Median, Industritë e Naftës, Gazit dhe Minerare, Organizatat Jofitimprurëse.

5.4. Vlerësime të Aktiviteteve Tregtare

Konsulencë tatimore që siguron pajtueshmërinë me legjislacionin tatimor dhe rregulloret zbatuese, Shërbimet tatimore, Planifikimi i taksave, Konsulencë dhe asistencë direkte në zbatimin e traktateve për shmangien e taksimit të dyfishtë të përfunduar nga Shqipëria, Shërbimet e konsulencës ligjore.

5.5. Vlerësime të Pasurive të Luajtshme & Paluajtshme

Nëse është për të shtuar një partner biznesi ose investitor, është e domosdoshme që ju të dini se çfarë është vlera e kompanisë suaj në mënyrë që të mund të merrni vendimin më të mirë të mundshëm. Nëse vendosni që ta shisni, atëherë do t'ju duhet një vlerësim i vlerës në mënyrë që ju të dini sa mund ta shisni biznesin tuaj.

5.6. Përgatitje Plan Biznes

Ne punojmë ngushtë me ju për të kuptuar qëllimet dhe vizionin tuaj, dhe pastaj të zhvillojmë një plan të qartë për biznesin tuaj për vitet e ardhshme. Ne shqyrtojmë supozimet, bëjmë hulumtime të pavarura, shqyrtojmë dhe propozojmë mënyra alternative për t'ju ndihmuar të arrini objektivat tuaja të biznesit. Ne jemi konsulentë, jo vetëm shkruar të plan-biznesit.

5.7. Shërbime Këshillimi të Specializuara

Shërbimet e këshillimit financiar studio "VIAR - Consulting" sh.p.k është e specializuar në dhënien e shërbimeve financiare të mëposhtme:

- Due diligences financiare dhe operacionale;
- Bashkime dhe përthithje;



- Shërbime të ristrukturimit;
- Vleresime të biznesit;
- Support enteve private dhe publike të përfshira në projekte të tipit Partneritete Publike Private;
- Kërkime dhe analiza të tregut; studime të krahasueshmërise.

6. Industritë


Studio jonë ofron një ekspertizë teknike të gjerë dhe njohuri të thellë mbi tregun lokal në auditim, taksa dhe shërbime këshillimi për klientët të cilët operojnë në sektorë dhe industri të ndryshme, përfshirë entitetet e mesme dhe të mëdha.

Jemi të përkushtuar në ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata me klientët, duke u fokusuar në kuptimin e perspektivës, nevojave dhe qëllimeve të tyre. Rezultatet janë zgjidhje biznesi inovative të dizenuara për nevojat unike të klientit, zgjidhje që optimizojnë performancën e firmës në mjedise rregullatore sfiduese, optimizojnë ekspozimin ndaj rrezikut dhe sigurojnë strategji kontabël tepër efektive edhe në industritë më konkurruese.

Sektorët kryesorë të angazhimit të firmës tonë përfshijnë: Prodhimin; Ndërtimin; Utilitetet, ujë, energji; Shitjen me Pakicë; Turizmin; Shëndetësinë; Teknologjinë dhe Telekomunikacionin; Agjencitë Qeveritare; Shërbimet profesionale; Transportin; Shpërndarjen; Edukimin; Median; Industritë e Naftës, Gazit dhe Minerare; Organizatat Jofitimprurëse; Sektorë të tjere.

7. Stafi Profesional





Fatime Alliu
Audituese Ligjore



Prezantim përmbledhës – Fokus te Cilësia dhe Etika Profesionale sipas SNA-ve

Fatime Alliu, Auditues Ligjor pranë "VIAR-Consulting" sh.p.k, ka një karrierë 40-vjeçare në sektorin ekonomik dhe financiar, nga të cilat 18 vitet e fundit i ka dedikuar auditimit ligjor. Formimi i saj profesional mbështetet në studimet në Financë-Kontabilitet dhe një MBA të përfunduar në bashkëpunim me University of Nebraska (USA).

Gjatë ushtrimit të detyrës si auditues ligjor, znj. Alliu demonstroi përkushtim të lartë ndaj cilësisë së shërbimit auditues, në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA/ISA) dhe Kodit të Etikës për Profesionistët e Financës.

Praktika e saj mbështetet në parimet kyçe etike:

- ✓ Integriteti profesional,
 - ✓ Objektiviteti dhe paanshmëria,
 - ✓ Konfidencialiteti dhe mbrojtja e informacionit,
 - ✓ Kompetenca dhe kujdesi profesional,
 - ✓ Sjellja profesionale dhe respektimi i kuadrit ligjor,
- Aftësia e saj për të zbatuar me rigorozitet standardet dhe për të ndjekur procedura metodologjike të qarta garanton:
- Vlerësim objektiv të rreziqeve,
 - Dokumentim të saktë dhe të plotë të çdo faze të auditimit,
 - Transparencë në konkluzione dhe komunikim të qartë me subjektet e audituara,
 - Vendimmarrje të mbështetur vetëm në prova audituese dhe standarde profesionale,

Përvoja e gjatë në sektorin publik dhe veçanërisht atë energjetik, përfshirë raportimin financiar pranë institucioneve ndërkombëtare (si World Bank, BERZH, FMN dhe Ministritë e linjës), i jep profilin të saj një qasje të strukturuar, të pavarur dhe me standard të lartë profesional.

E drejtuar nga parimet e lidershit etik, znj. Alliu nxit kulturën e transparencës, saktësisë dhe përgjegjshmërisë, duke qenë një shembull i qartë i profesionalizmit në shërbim të interesit publik dhe të besueshmërisë financiare.



Kondor Çeka

Financë Kontabilitet - Auditues Ligjor

Diplomuar në Fakultetin Ekonomik të Tiranës me eksperiencë profesionale 22 vjeçare, nga të cilat 11 vjet në zyrat Qendrore të KESH sh.a. Gjatë kësaj periudhe ka mbuluar detyra të ndryshme si specialist dhe drejtues në Degën Ekonomike të Divizionit të Shpërndarjes dhe Drejtorinë Ekonomike të KESH sh.a. Kjo eksperiencë e gjatë ka ndikuar në rritjen e vazhdueshme profesionale dhe njohjen e thellë të sektorit energjitik dhe veçorive të kësaj koorporate. Është njohur dhe ka përvetësuar standarte dhe eksperiencë ndërkombetare të fushës ekonomike-financiare, si dhe ka bashkëpunuar me ekspertë vendas dhe të huaj për studime, metodologji dhe akte ligjore të lidhura me sektorin elektroenergjitik. Gjithashtu ka drejtuar tërë sektorin ekonomik të Electronet Albania sh.p.k. Është i orientuar nga rezultati dhe cilësia, ka aftësi menaxheriale dhe di të punojë në grup duke përvetësuar lehtësisht rolin e liderit. Ka aftësi komunikuese, negociuese dhe bashkëpunuese. Prej rreth 7 viteve ka punuar pranë zyrës së Studios "VIAR-Consulting", deri në Gusht 2021. Në vitin 2021 ka marrë edhe titullin "Auditues Ligjor", dhe që nga Shtatori 2023 e ushtron profesionin në mënyrë të pavarur dhe punon me kontratë shërbimi pranë studios "VIAR-Consulting" sh.p.k.

Artiola Lusha

Financë-Kontabilitet (Stazhier AL)

Diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë në vitin 2019 me titullin master profesional në Kontabilitet dhe Auditim dhe me eksperiencë profesionale 3-vjeçare në fushën e ekonomisë dhe financës. Aktualisht punon pranë studio "VIAR" Consulting. Gjatë kësaj periudhe ka mbuluar detyrat e mëposhtme:

a) si përgatitja e faturave tatimore, deklarimeve, urdhertransfertave, kontrolli dhe azhurnimi i të dhënave financiare, b) kontrolli dhe azhurnimi i të dhënave financiare; c) përgatitja e raporteve mujore ose vjetore të nevojshme angazhuar në përpunimin e pasqyrave financiare etj. Artiola ka njohuri shumë të mira në gjuhën angleze dhe programeve softëare dhe financiare. Ajo ka aftësi shumë të mira komunikuese, përkushtim, korrektësi dhe përgjegjshmëri në kryerjen e detyrave që i ngarkohen në punë.

Klajdi Kadillari

Analist Audit (Stazhier AL)

Diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë në vitin 2015 me titullin Master Profesional në Financë dhe me eksperiencë profesionale 7-vjeçare në fushën e ekonomisë dhe financës, në pozicionin analist financiar dhe auditim. Gjatë kësaj periudhe është angazhuar në përpunimin dhe analizimin e të dhënave bankare: llogarive rrjedhëse dhe kredive konsumatore (Për banka /institucione krediti apo klientë individual në Republikën e Italisë); analizimi i planeve të amortizimit dhe planit të pagesave të kredive dhe verifikimi i konformitetit të elementeve të mësipërm me bazën ligjore në Republikën e Italisë.

Që prej Mars 2021 dhe aktualisht punon pranë studio "VIAR-Consulting" sh.p.k. Gjatë kësaj periudhe ka mbuluar detyrat e mëposhtme:

a) Asistuar në auditimin e pasqyrave financiare si dhe projekteve të tjera financiare të ndryshme; b) Angazhuar në përpunimin e bilanceve, pasqyrave të të ardhurave dhe pasqyrave të tjera financiare sipas udhëzimeve ligjore dhe kontabël të firmave; c) Kontrolli dhe azhurnimi i të dhënave financiare,



përgatitja e raporteve mujore ose vjetore financiare të nevojshme etj; d) asistimin e partnerit të angazhimit në të gjitha proceset e angazhimeve të Auditimeve Ligjore (SNK dhe SNRF) dhe Shërbimeve të tjera të dhënies së sigurisë. Ka njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, italiane dhe progameve software. Përpikmëria, korrektësia dhe qasja profesionale në punë janë tipare dalluese të tij. Gjithashtu, Klajdi shpalos aftësi shumë të mira komunikuese dhe prezantuese, qasje proaktive dhe nxitës i frymës së bashkëpunimit në grup.

Naim Alliu

Aministrator

Diplomuar në Fakultetin e Veterinarisë, Kamëz Anagazhimi i Z. Alliu ka qënë dhe është konsistent gjatë gjithë konë që nga themeli i saj, prej rreth 15 vite. Z. Alliu ka mbuluar dhe vazhdon të mbulojë menazhimin e studios në funksion të aktivitetit .